VENDIM
Nr.484, datë 23.6.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar, i cili të kryesohet nga z.Ernest Noka, nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, dhe të ketë në përbërje këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

a) Aduart Ypi — Ministria e Financave;
b) Egon Babameto — Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
c) Etion Kapedani — Ministria e Brendshme;
ç) Luigj Aleksi — Shoqata e Kontraktorëve;
d) Ilir Zhilla — Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
dh) Orhan Sakiqi — Shoqata e Inxhinierëve Konsulentë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve/Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha